



Njoftim për Ndërtim Shtëpie

Data e përgatitjes së njoftimit: 25/06/2022

T- 14/2022

Detajet për kontakt:

Adresa Postare: Rr. Bajram Kelmendi nr 10/A, lagjja Katër Llullat		
Qyteti: <i>Prishtinë</i>	Kodi postar: <i>10000</i>	Vendi: <i>Prishtinë</i>
Personi kontaktues: <i>Zyra e Prokurimit - IR Kosova</i>		Telefoni: <i>038/232-431</i> Mobil: <i>+38344239349</i> Email: procurement@ir-rks.org

Përshkrimi

Islamic Relief është një organizatë humanitare ndërkombëtare me qendër në Birmingham të Britanisë së Madhe dhe e shtrirë në më shumë se 40 shtete të botës përfshirë Kosovën ku aktivitetin e ka filluar menjëherë pas lufte në vitin 1999 si Islamic Relief Kosova (IRK). Gjatë kësaj periudhe (më shumë se 20 vite) IRK ka implementuar projekte të ndryshme me karakter humanitar dhe zhvillimor, duke filluar prej atyre emergjente, edukative, shëndetësore, infrastrukturë, bujqësi, blegtori si dhe financiare me anë të cilave ka kontribuar në zbutjen e brengave dhe nevojave të familjeve dhe individëve skamnorë në Kosovë.

Pjesë e projekteve të ndryshme me karakter humanitar/zhvillimor është projekti që ka për qëllim ndërtimin e tri shtëpive me jetim ne komuna te ndryshme te Kosovës. Islamic Relief Kosova do të bëjë implementimin e projektit.

Implementimi i projektit bëhet në bazë të kritereve të përcaktuara nga Islamic Relief Kosova.

Periudha e implementimit (ndërtimit të shtëpisë): Do të jete nga data 25.07.2022 deri me 15.11.2022.

Të gjithë operatorët ekonomik që janë të interesuar për aplikim për këtë tender, plani i shtëpisë me para masa dhe parallogaritë duhet kërkuar përmes Email: procurement@ir-rks.org

Dokumentacioni që kërkohet të bashkëngjitet dosjes se tenderit:

	Dokumentacioni ligjor	Lloji
1.	Certifikate e Biznesit	Kopje
2.	Certifikata e TVSH-së	Kopje
3.	Deklaratë me shkrim nga operatori ekonomik në të cilën thuhet se do t'i përmbahet të gjitha detyrimeve për kryerjen e shërbimeve nga ky tender	E vulosur dhe e nënshkruar nga kompania

4.	Referencë e implementimit të ndonjë projekti të ngjashëm	E vulosur dhe e nënshkruar nga kompania bashkëpunuese
5.	TVSH – “Faturimi do të bëhet pa TVSH, duke shënuar në faturë referencën e nenit 33, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.05/L-037 për TVSH” nga vendimi shpjegues publik nr 04/2016	0.00

Vërejtje: Ofertat tuaja me dokumentacionin e tenderit duhet ti dërgoni në një zarf të mbyllur me titull **“Oferta për ndërtim Shtëpie - Islamic Relief Kosova”**- duke i sjellur ato në adresën: rruga Bajram Kelmendi nr.10/A, 10000 Prishtinë.

Islamic Relief Kosova – ka zero tolerance ndaj çdo thyerje të procedurave si me poshtë:

- **Politikat kundër Ryshfetit dhe Korrupsionit.**
- **Kodi i Sjelljes.**
- **Respektimi dhe mbrojtja e grupeve Vulnerabël (përfituesëve) të IRK-së.**

Ofertat në zarf duhet të dërgohen në adresat e lartcekura më së voni deri më **datë 07/07/2022 në ora 15:00**. Çdo ofertë e cila vjen pas kësaj date do të llogaritet e vonuar dhe si e tillë nuk do të merret në shqyrtim nga prokurimi.